



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:052730

Datë: 27.05.2022

Numri i dokumentit: 03064981

PPP.nr.68/2019

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përmbartimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike të kreditorit KRM A... SH.A Njësia operative Istog, kundër debitorit F. R. M. Fsh. S. Rr. B. .. K-Istog, për shkak të borxhit në shumë prej 148.45 €, pas prapësimit të ushtruar nga ana e debitorit, me dt.30.05.2019 kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit, gjykata jashtë seance me dt.27.05.2022 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË prapësimi i debitorit: F. R. M. Fsh. S. Rr. B. .. K-Istog, ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.305/2021 të dt.30.04.2019 për shkak të borxhit në shumë prej 148.45 €, si i PA AFATSHËM.

A r s y e t i m

Kreditori, KRM A... SH.A Njësia operative Istog, ka ushtruar propozimin për përmbartim të përmbartuesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbartimi ndaj debitorit: R. M. Fsh. S. K-Istog, si në shkresat e lëndës, për borxh në shumë prej 148.45€, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, të gjitha këto në afat 7 ditor nga pranimiti i urdhrit, në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare të debitorit, sekuestrimi regjistrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, e shuma e mjeteve të transferohet në llogari të kreditorit, të gjitha të specifikua në propozimin për përmbartim të datës 30.04.2019.

Përmbartuesi privat me urdhër P.nr.305/2019 të dt.30.04.2019 e ka lejuar propozimin për përmbartim.

Pas lejimit të përmbartimit me urdhër përmbartimor, të njëjtin përmbartuesi privat ja ka dorëzuar debitorit të cilin e ka pranuar F. M. me datë 22.05.2019 me paralajmërimin se pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqes prapsim në afat 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit.

Debitori, Komuna e Istogut, ka ushtruar prapsim me dt: 30.05.2019 kundër urdhrorit për përmbarim P.nr.305/2019 të dt.30.04.2019, me te cilën është lejuar përmbarim sipas propozimit të kreditorit KRM A... SH.A Njësia operative Istog.

Gjykata sqaron faktin se pasi që u vërtetu se tani i ndjeri R. M. ish nga Fsh. S. K-Istog ka ndërrua jetë ku ky fakt vërtetohet nga certifikata e vdekjes e dt. 27.05.2022 ku konstatohet se me dt. 07.01.2016 ka nderu jetë, dhe pasi që vërtetohet se parashtruesi i prapësimit F. R. M. Fsh. S. Rr. B. .. K-Istog është i biri i tani të ndjerit R. M. , gjykata duke marr parasysh parimin e ekonomizimit te procedurës si dhe duke marr parasysh faktin se biri i tani te ndjerit disponon me pasurin e te njëjtit, gjykata nuk veproj konform nenit 35 par.4 te LPP-së ne atë mënyrë qe ta ndërpres procedurën deri sa te caktohen trashëgimtarët te cilët disponojnë me pasurin e debitorit, andaj F. R. M. Fsh. S. Rr. B. .. K-Istog, parashtrues i prapësimit e ka marr përsipër procedurën përmbarimore konform par. 6 te nenit 35 i cili nen parasheh se “Pas mbarimit të bashkësisë trashëgimore, secili nga trashëgimtarët mund ta marrë përsipër procedurën përmbarimore duke iu paraqitur organit përmbarues”.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se debitori, nuk ka vepruar brenda afatit ligjor të përcaktuar për paraqitjen e prapsimit kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbarimit, andaj gjykata, bazuar ne nenin 70 te Ligjit të Procedurës Përmbarimore i cili thotë citoi “Prapësimi duhet ti paraqitet gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrorit përmbarues” e në rastin konkret debitori F. R. M. Fsh. S. Rr. B. .. K-Istog e ka pranuar propozimin për përmbarim të lejuar me urdhër me datë 22.05.2019 dhe afati ka filluar të ecë nga data 23.05.2019 ndërsa prapësimin e ka parashtruar me datë 30.05.2019, e nga pranimi i propozimit të përmbarimit e deri me ditën e paraqitjes së prapësimit kanë kaluar 8 ditë, e në rastin konkret afati i fundit për ngritjen e prapësimit ka qenë data 29.05.2019, ashtu që prapësimi i debitorit konsiderohet si I PA AFATSHËM.

Andaj, nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 35 par.4 dhe 6, 70, 73.3 të LPP-së (Ligjit të Procedurës Përmbarimore), u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
PPP.nr.68/2019, dt.27.05.2022

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.